REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E AVOKATEVE SHKODER

Shkoder at 20.11.1996

KONTRATE-SHITJE-KUOTASH
TE KAPITALIT THEMELTAR

Sot ne daten 20.11.1996(njezet Nentor njemije e nenteqinde e nentedhjete e gjashte) diten e Merkure,u paraqiten personalishte palet kontraktuse Si Shitesa: Z;Sergio Adelchi dhe Luca Sergio, ortake te shoqerise"Adelc Sh.p.k. nga njera ane dhe Paulin Radovani dhe Cinzia Sergio nga ana tjete si bleresa.

Sergio Adelchi dhe Luca Sergio deklarojne se kuotata e tyre te pjesmarjes ne kapitalin themeltar te shoqerise- ja u shesin ortakeve:Paul Radovani dhe Cinzia Sergio,e konkretishte: Sergio Adelchi pjesen e vete te kapitalit prej 50% ose 750.000 US Dollare e shet-Paulin Radovanit 40% te kuotes se vete e ky i fundit duke patur ky i fundit dhe pjesen e vete prej 10% behet zoterues i 50% te kapitalit ose te shumes prej 750.000 US Dollare.Sergio Adelchi i shet Cinzia Sergios(Adelchit) pjesen e mbetur te kapitalit te tije prej 15% Kurse Luca Sergio(Adelchi) i shet pjesen e vete prej 35% po Cinzia Sergios,duke u bere kjo e fundit keshtu zoterues e 50% te kapitalit ose e 750.000 US Dollareve,te kapitalit te shoqerise.

Palet ne kete kontrate te transferimit e shitjes se kuotaes se kapitalit,kane bere likujdimet e nevojeshme,duke u bere keshtu perfundimisht ortaket Paulin Radovani dhe Cinzia Sergio,pronare te kapitalit themeltar te shoqerise ne shumen 1.500.000 US dollare,ne pjese te barabarta nga 50 sejcili,ose te shprehura ne Dollare nga 750.000 US Dollare sejcili.

Palet Kontraktuse

| Shitesa | Bleresa |
|---|---|
| Sergio Adelchi. Luca Sergio(Adelchi) | Paulin Radovani.Cinzia Sergio(Adel |

DHOMA E NOTEREVE SHKODER

Nr.Repertori 2986
Nr.Koleksioni 1151

AUTENTIFIKIM - NENSHKRIMI

Sot ne daten 20.11.1996 u paraqiten palet kontraktuse te siperpeshkrua te cileve ju vertetova permbajtjen e akti dhe nenshkrimet.

N o t e r e
Elvira Alibali

5.5.94 198

BANKA KOMBËTALE TREGTARE
BANQUE NATIONALE COMMERCIALE

NXJERRJE LLOGARIE – RELEVÉ

| Nr. llogarisë / No compte | PËRSHKRIMI / DESCRIPTION | Data / Date | Lëvizjet në valutë / Mouvements en devise | | Teprica e re në valutë / Nouveau solde en devise | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Debit (—) | Kredit (+) | Debit (Dt) | Kredit (C |
| 2640107 07 | 7432253 4.4 | 5 V 94 | 2836020 47.00 | | 2092 79.462.55 * | |

Shënim: Gabimet në nxjerrjen e llogarisë duhet t'i njoftohen kryellogaritarit të bankës brënda 5 ditëve

(Mod. 40 A)

ALIER DE COMPTE

Mod. 57

| Teprica e mëparshme në lek<br>Solde anterieur en leks | | Lëvizjet në lek<br>Mouvements en leks | | Teprica e re në lek<br>Nouveau solde en leks | |
|---|---|---|---|---|---|
| Debiti (Dt) | Krediti (Cr) | Debit (—) | Kredit (+) | Debit (—) | Kredit (Cr) |
| 9.573,15 | | 16.931.042,20 | | 16940615 35* | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

PULLE TAKSE

Nr. rep 62 Nr. kol 37

**KONTRATE DHURIMI PASURIJE**
**50 % TE KUOTAVE TE SHOQERISE**
**"Adelchi-Shqiperia" sh.p.k.**

Në Dhomen e Noterise Tirane, dhe para meje, Gentiana Broci **Noter**, me seli ne rrugen "Dos Bosko", prane Gjykates se Faktit, sot me date 26. 9. 2005(dymije e pese), diten e , u paraqiten personalisht palët e poshtëshenuara kontraktuese:..........

**DHURUESE** : ***Cinzia Sergio***, e bija e Sergios, dtl. 12 Gusht 1971, lindur ne Casarano, e banuese ne Itali, me cilesine e ortakes me 50 % te kuotave te shoqerise "Adelchi-Shqiperia" shpk, rregjistruar ne Gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr. 4267/2 date 18 Dhjetor 1996, e identifikuar ne baze te pasaportes nr. B 170825..........

**PRANUES DHURIMI** : **Paulin Radovani**, i biri i Koles, dtl. 28 Qershor 1946, lindur e banues ne Shkoder, lagja "Tre Herojt", rruga "Papa Gjon Pali II", me cilesine e ortakut dhe te administratorit, me 50 % te kuotave te shoqerise "Adelchi-Shqiperia"
shpk,..........

**Perkthyes** :

Per identitetin e te cileve u sigurova ane baze te dokumente te tyre identifikues, madhore e me te gjithe aftesite e kerkuara nga ligja..........

Sipas dokumeneteve te paraqitura rezulton :

1. Ne baze te vendimit nr. 4267 date 18 Maj 1994 eshte rregjistruar si person juridik Shoqeria "Adelchi" sh.p.k. me qender ne qytetin e Shkodres.

Paulin Radovani                Cinzia Sergio

2. Ne baze te vendimit nr. 4267/1 date 5 Janar 1995 eshte vendosur :

A. Ndryshimi i kapitalit te Shoqerise nga 3.000.000 $ ne 1.500.000 $.

B. Largimi i ortakut Antonio Urbani, dhe

C. Shtimin e ortakut Luca Sergio, etj.

3. Me vendimin e Gjykates se Tiranes nr. 4267/2 date 18 Dhjetor 1996 eshte vendosur largimi i ortakeve Segio Adelchi dhe Luca Sergio(Adelchi) dhe pranimin e ortakes Cinzia Sergio, duke mbetur keshtu Shoqeria "Adelchi" sh.p.k., me dy ortake z.z. Paulin Radovani dhe Cinzia Sergio, secili me nga 50 % te kapitalit themeltar.

4. Theksohet se kjo Shoqeri, ne Ngjarjet e Marsit 1997 eshte grabitur e shkaterruar, dhe qe nga ajo kohe nuk zhvillon aktivitet ekonomik, prodhues e tregtar, dduke patur dhe detyrime ndaj organeve te shtetit shqiptar.

Te dy ortaket, me vullnetin e tyre vendosin, te realizojne kete akt transferim kuotash (50 % ne vleren 750.000 $) te Shoqerise "Adelchi-Shqiperia" sh.p.k., ku ne disa dokumente shenohet shkurtimisht "Adelchi", sipas kushteve te percaktuarar dhe te pranuara prej tyre, si poshte: ..............

**NENI 1. Objekti i kontrates.**

Kjo kontrate do te kete si objekt transferimin (dhurimin) e kuotave te Shoqerise "Adelchi-Shqiperia" shpk, rregjistruar ne Gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr. 4267/2 date 18 Dhjetor 1996, nga ortaku qe zoteson 50 % te ketyre kuotave znj. Cinzia Sergio, tek ortaku dhe administratori qe zoteron 50 % te kuotave z. Paulin Radovani. ..............................................

Sipas vendimit nr. 3 date 26.09.05,te Asamblese se Ortakeve, ne momentin e realizimit te aktit te transferimit (dhurimit) te kuotave ne pronesi te ortakes znj. Cinzia Sergio, te barazvlefshme me 50 % te kuotave, eshte ne shumen 750.000 $(shtateqind e pesedhjetemije dollare amerikane). ......

Ne kuotat e mesipertreguara perfshihen vlerat e ndertesave, te trojeve e te tokes, si dhe te gjithe aseteve, pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme, qe zoteron kjo Ndermarje.......................................................

**NENI 2. Dhurimi.**

Paulin Radovani

Cinzia Sergio

Ortaket bien dakord qe 50 %(750.000 $) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise te kalojne ne pronesi te ortakut dhe administratorit qe zoteron 50 % (750.000 $) te kuotave z. Paulin Radovani, me ane te dhurimit te ketyre kuotave te kapitalit themeltar, dhe pranuesi i dhurimit, duke shprehur mirenjohje, e pranon dhurimin e bere, dhe me gjithe pjesen e vet takuese prej 50 % (750.000 $) ne kete Shoqeri, behet pronar i plote dhe i pakontestueshem i 100 % (750.000+750.000=1.500.000 $) te Shoqerise "Adelchi-Shqiperia" sh.p.k., ku ne disa dokumente shenohet shkurtimisht "Adelchi".

**NENI 3. Detyrimet e paleve kontraktuese.**

Pala pranuese e dhurimit te kuotave te kapitalit te Shoqerise "Adelchi-Shqiperia" shpk, ortaku dhe administratori z. Paulin Radovani, duke u bere pronar i te gjithe Shoqerise, merr persiper dhe te drejtat e detyrimet qe kjo Shoqeri ka me organet e shtetit shqiptar.

Pala dhuruese, ortaku znj. Cinzia Sergio, pas nenshkrimit te kesaj kontrate, heq dore nga çdo pretendim ne lidhje me veprime apo levizje kontabile ne shoqerine "Adelchi-Shqiperia"shpk (ku ne disa dokumente shenohet shkurtimisht "Adelchi") dhe dalja e saj nga shoqeria eshte e plote dhe e parevokueshme, duke mbetur keshtu krejt pa pronesi ne kete Firme. ......

**NENI 4. Rregjistrimi ne Gjykaten e Tiranes.**

Rregjistrimi i kontrates se dhurimit behet nga ana e pales pranuese e dhurimit, ku e gjithe Shoqeria, pra 100 % te kuotave te kapitalit themeltar, do te rregjistrohet ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Tiranes, ne emrin e pronarit te ri, ortakut te vetem dhe administratorit te kesaj Shoqerie, z. Paulin Radovani.........................................................................................................

**NENI 5. Zgjidhja e mosmarreveshjeve.**

Te gjithe mosmarreveshjet qe mund te lindin nga zbatimi i kesaj kontrate, te zgjidhen me pajtim nga palet.........................................................

Ne rast pamundesi zgjidhje paqesisht dhe me marreveshje te paleve, kompetente do te jete Gjykata e rrethit Tirane. .......................................

**NENI 6. Dispozita te ndryshme.**

Paulin Radovani

Cinzia Sergio

Per çdo gje te paparashikuar ne kete kontrate, palet i referohen legjislacionit shqiptar ne fuqi.........................................................................................

Aktit i bashkelidhen dhe vendimet e sipertreguara te Gjykates se rrethit Tirane. ...............................................................................................

Kjo kontratë, e cila permban kater faqe, pasi u lexua me zë të lartë para palëve kontraktuese( e perkthyer dhe ne italisht, si dhe ne prezence te perkthyesve te autorizuar dhe nga pala dhuruese), të cilët, duke u gjetur konform kërkimit dhe vullnetit të tyre të plotë, në prezencen time, e pranuan atë, dhe e nënshkruan si poshte rezulton: ...............................................................

**Palët kontraktuese**

**Dhuruese** **Pranues i dhurimit**

**Te pranishem.** **Noter**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

Shkoder, me 29.8.8 .2005

## PROÇES VERBAL

**Mbledhja e Asamblese se ortakeve te shoqerise me kapital te perbashket "Adelchi-Shqiperia" Sh.p.k Shkoder**

Sot me date 29.08.2005, ora 14 $^{00}$, ne qendren legale te shoqerise me kapital te perbashket "Adelchi-Shqiperia" Sh.p.k Shkoder, u zhvillua mbledhja e Asamblese se ortakeve, per te diskutuar dhe vendosur mbi problemet e parashtruara ne rendin e dites :

1. Miratimi per regjistrimin ne gjykate si sh.p.k "Adelchi-Shqiperia", te shoqerise me kapital te perbashket "Adelchi-Shqiperia" Sh.p.k Shkoder, sipas kuotave te kontributeve te percaktuara nga ekspertet dhe te miratuara.
2. Te ndryshme.

Eshte ora 14 $^{00}$ dhe rezultojne te pranishem :

- Xhilda Konçi, me cilesine e perfaqesuesit te ortakut shteteror te shoqerise me kapital te perbashket "Adelchi-Shqiperia" Sh.p.k Shkoder, ne baze te autorizimit dhe qendrimit te Ministrit te Ekonomise nr. 4684/1, date 29.08.2005.
- Paulin Radovani, me cilesine e perfaqesuesit te ortakut jo shteteror te shoqerise me kapital te perbashket, ne baze te prokures NR. Rep 6471, NR. Kol 1507, date 05.07.2005, bashkelidhur.

Mbi piken e pare te rendit te dites, pasi u diskutua lidhur me regjistrimin ne Gjykaten e Tiranes, te shoqerise me kapital te perbashket "Adelchi-Shqiperia" Sh.p.k Shkoder, si sh.p.k "Adelchi-Shqiperia", u vendos unanimisht miratimi i saj.

Per piken e dyte te rendit te dites, te ndryshme, pasi nuk kishte diskutime, Asambleja deklarohet e mbyllur.

Proçes verbali mbahet ne kater kopje, nga te cilat dy kopje mbahen nga ortaket e shoqerise me kapital te perbashket.

O R T A K E T

Perfaqesuesi i ortakut shteteror
Xhilda KONÇI

Perfaqesuesi i ortakut jo shteteror
Paulin RADOVANI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**V E N D I M**

**Nr.3, date 29.08.2005**

Asambleja e ortakeve te shoqerise me kapital te perbashket "Adelchi-Shqiperia" Sh.p.k Shkoder, e mbledhur me date 29.08.2005, ora $14^{00}$, sipas rendit te dites te njoftuar me pare, ne mbeshtetje te akteve te themelimit, te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te Ligjit nr.8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare",

V E N D O S I :

1. Te behet regjistrimi i shoqerise, sipas percaktimeve te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

O R T A K E T

Perfaqesuesi i ortakut shteteror

Xhilda KONÇI

Perfaqesuesi i ortakut jo shteteror

Paulin RADOVANI

**RAPORT VLERESIMI**

**TE SHOQERISE ADELCHI-SHQIPERIA sh.p.k.**

Ne te quajturit Mimoza Sula e Artan Golemi, ne profesionin e ekspertit kontabel te autorizuar, te paisur me licence profesionale respetivisht me nr.78 e 80, me vendimin e dates 03.06.2005, te asamblese se ortakeve te ndermarrjes te perbashket "ADELCHI-SHQIPERIA" (A.SH) Shkoder, kemi mare detyren per vleresimin e kontributeve te paleve gjate akitvitetit te saj.

Per kryerjen e kesaj detyre ne kemi disponuar bilancin e shoqerise te hartuar ne daten 31-12-1992 se bashku me raportin e kontrrollit te llogarive te vitit 1993, si dhe disa situacione punimesh dhe likuidime te investimeve te viteve 1991-1992.
Shume dokumenta mungojne si rezultat i ngjarjeve te ndodhura ne vitin 1997.

Nderrmarja e Perbashket "ADELCHI-SHQIPERIA" (A.SH) me seli ne Shkoder, eshte krijuar sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.396 dt. 26-11-1990, ndermjet fabrikes se lekure-kepuces dhe firmes italiane "Calzaturificio ADELCHI-Specchia (Lecce) Italia" me afat te veprimtarise deri ne 10 vjet.

Sipas kontrates per kostituimin e nderrmarjes se bashkuar shqiptaro-italiane nenit 5 te saj kapitali Themeltar i nderrmarjes eshte percaktuar 30,000,000 leke e ndare me pjesmarrje si me poshte.:

| | |
|---|---|
| 1, SERGIO ADELCHI | me leke 15,000,000 |
| 2, FABRIKA LEKUR KEPUCA Shkodra | me leke 15,000,000 |

Sipas ketij neni ortaku shqipetar merr persiper gjithashtu ti gjeje dhe siguroje ndermarjes lokalet,ndertesat,zyrat dhe ngrehinat te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise se vet,ndersa ortaku italian detyrohet te funizoje gjithashtu ndermarjen me makineri,me paisjet e nevojshme si dhe lendet e para ndihmese.

Sipas bilancit te vitit 1992, jane perfshire ne vleren e Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara jane perfshire dhe vlefta e makinerive te sjelle nga Italia me gjithsej 68,363,198 leke.

Aktiviteti ekonomik i Ndermarjes ka pushuar se ekzistuari ne vitin 1993, mbasi ortaket nuk respektuan kushtet e kontrates.Kjo vertetohet edhe nepermjet shkresave qe na u vune ne dispozicion te cilat vertetojne qe ortaku shteteror nuk ju pergjegj kushteve ne kontrate.

Verefikimi u krye mbi bazen e dokumentave te vene ne dispozicion si dhe na u dhane shpjegime plotesuese per elementet e bilancit te shqyrtuar.

Sipas vertetimit te leshuar nga Administratori i deleguar zt Paulin Radovani me date 5-11-1992 dhe te vertetuar nga financieri i ndermarrjes se perbashket zt. Nikolin Kovaci,ortaku shteteror shqipetar qe nga data e fillimit te punes ne kete ndermarje deri ne kete date nuk ka derdhe detyrimin financiar per shumen 15 milion leke. Kete gje e verteton edhe shkresa e Ministrise se Industrise se Lehte nr. 79 Prot. date 28.01.1992, derguar Presidentit te Firmes Calzaturificio ADELCHI-Specchia*Lecce (Italia) ku sqaron pamundesine financiare e ortakut shtetror qe nuk arriti te plotesoje detyrimin per te cilen kishin nenshkruar ne ndermarjen e perbashket si dhe pranon investimin e kryer nga pala Italiane.Sipas konfirmimit te bere nga dega e tatim taksave te rrethit te Shkodres date 13.06.2005 ku eshte paraqitur relacioni i bilancit te vitit 1992 mbi ndarjen e fitimit te vitit 1992, kontributet e ortakeve te vleresuar me cmimet e periudhes kur eshte krijuar ndermarjea e perbashket, jane si me poshte:

| | |
|---|---|
| Ortaku Shteteror | |
| Vlera e nderteses se fabrikes | 1.992.306 leke |
| Vlera e nderteses se kordonit | 885.339 leke |
| Siperfaqja e truallit ku shtrihet aktiviteti 11580m2 | 724.200 leke |
| **Totali** | **3.601.845 leke** |
| **Ortaku Italian** | **75.569.000 leke** |
| **Totali** | **79.170.845 leke** |

Sipas vlerave te paraqitura ortaku shteteror zoteron 4.55% te kontributeve ndersa ortaku Italian zoteron gjithesej 95.45% te kontributeve.

Nga ana tjeter nga ana e eksperttit vleresues te marre nga Perfaqsuesi i ortakut Italian zt. Paulin Radovani rezulton se vlera aktuale e mbetur e fabrikes "ADELCHI – SHQIPERIA", ish Fabrika e makaronave Shkoder ne momentin e vleresimit eshte 29.934.681 leke ndersa vlera e truallit eshte 12.800.000 leke.

Mbeshtetur ne dokumentacionin e vene ne dispozicion nga ana e ortakeve likuidimi nuk eshte kryer.

Eksperti Kontabel Autorizuar

Artan GOLEMI

Mimoza SULA

EkspertKontabëlAutorizuar ARTAN. GOLEMI TIRANË ALBANIA

**Tirane me 26.06.2005**

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR MIMOZA SULA NR. ALBANIA

E njejte me origjinalin V. Huraslui

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "ADELCHI SHQIPERIA" SH. P. K., SHKODER

# V E N D I M NR. 7

Ne baze te vendimit te Gjykates se rrethit Tirane, eshte rregjistruar si person juridik Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "Adelchi Shqiperia" sh.p.k., Shkoder, rregjistruar si aktivitet privat qe me date 27 Mars 2000, dhe ne QKR me NIPT K 06424016 C, me ortak z. Paulin Radovani me 95.45% = 331.497,85 te kuotave dhe Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes me 4,55% = 15.802,15 te kuotave te kesaj shoqerie, ku administrator eshte z. Paulin Radovani, me objekt, seli e kapital themeltar te ditur..................(..R..)..........................................................................................

Ne mbledhjen e dates 8 Tetor 2013, dhe sipas njoftimit te bere sipas ligjit, ligji 9901 date 14 prill 2008, ku me kerkesen nr. 16/9 date 16 Shtator 2013, dhe Lajmerim marje nr. 000104928, date 28 Shtator 2013; METE ka marren njoftim per mbledhjen e Asamblese se Ortakeve, dhe nuk jane paraqite.

Keshtu, ne kete mbledhje, u be analiza e punes se kryer, dhe ne te mire te punes se kesaj firme, u mor ne shqyrtim akti i dhurimin te kuotave te kapitalit/transferimin (dhurim) i 95.45 % kuotave te Shoqerise "Adelchi Shqiperia" Sh.p.k., kuota qe kalojne nga z. Paulin Radovani, tek znj. Filomena Radovani, e cila behet bashkepronare e 95.45% = 331.497,85 te Shoqerise "Adelchi Shqiperia" Sh.p.k., Shkoder, ndersa 4,55 % mbetet/n ne favorin e Min. Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Tirane(METE).

Po keshtu, u mor ne shqyrtim dhe mundesia e caktimit te z. Filomena Radovani si administratore e kesaj Shoqerie, per afatin e lejuar 5 vjeçar

Gjithashtu u pa dhe mundesia e zgjatjes se afatit te veprimtarise se kesaj Shoqerije, ne ate me afat te pakufizuar.

Prandaj,

U vendos :

1. Miratimi i aktit te dhurimit se kuotave te kapitalit themeltar e 95.45 % date 8 Tetor 2013, noter A. S. Kopliku, Shkoder, me te cilin i jane dhuruar 95.45 % = 331.497,85 leke te kuotave te kapitalit themeltar znj. Filomena Radovani, e duke u bere keshtu bashkepronare e Shoqerie " Adelchi-Shqiperia", ajo vete(zj. Filomena Radovani).
2. Administratore per nje afat 5 - vjeçar te rinovueshem do te jete znj. Filomena Radovani.
3. Zgjatja se afatit te veprimtarise se kesaj Shoqerije, ne ate me afat te pakufizuar.
4. Rregjistrimin e ketij vendimi prane organit perkates, QKR Shkoder.

Miratimi i sa siper, e nenshkruaj si ma poshte vijon :

Filomena Radovani

Paulin Radovani

